

No. 06. Prot.  
dt. 09.01.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Nr. 1319 Prot.

Tiranë, më 6.1.2022

## VENDIM I ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME

Nr. 21 datë 6.1.2022

### PËR

#### MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME ANË TË PËRTHITHJES SË SHOQËRIVE "BURSA E TIRANËS" SH.A. NË LIKUIDIM, "BERATEKS" SH.A. NË LIKUIDIM, "KOMBINATI ENER GjITIK" SH.A NË LIKUIDIM DHE "NIMEKS" SH.A NË LIKUIDIM ME SHOQËRINË PËRTHITHËSE "PETROL ALBA" SH.A NË LIKUIDIM

Në mbështetje të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Urdhrit nr.112, datë 25.03.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për ngritjen e grupit të punës për analizimin e situatës funksionale, financiare dhe operacionale të shoqërive tregtare aksionare me kapital tërësisht shtetëror me pamundësi financiare për të shërbyer detyrimet", raportit përfundimtar të grupit të punës, të Urdhrit nr.106, datë 26.11.2019 "Për bashkimin me shoqërinë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim, me anë të përthithjes të shoqërisë "Bursa e Tiranës" Sh.a në likuidim", të Urdhrit nr.107, datë 26.11.2019 "Për bashkimin me shoqërinë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim me anë të përthithjes të shoqërisë "Berateks" Sh.a në likuidim", të Urdhrit nr.108, datë 26.11.2019 "Për bashkimin me shoqërinë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim me anë të përthithjes të shoqërisë "Kombinati Energjitik" sh.a. në likuidim" dhe të Urdhrit nr.109, datë 26.11.2019 "Për bashkimin me shoqërinë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim me anë të përthithjes të shoqërisë "Nimeks" Sh.a në likuidim", si dhe të statutit të shoqërive, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërive.

### VENDOSA :

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkimit me anë të përthithjes të shoqërive "Bursa e Tiranës" Sh.a në likuidim, "Berateks" Sh.a në likuidim", "Kombinati Energjitik" sh.a. në likuidim dhe të shoqërisë "Nimeks" Sh.a në likuidim me shoqërinë përthithëse "Petrol Alba" sh.a. në likuidim.

2. Kapitali themeltar i shoqërisë përrthithëse “Petrol Alba” sh.a. në likuidim bëhet 3,980,688,000 lekë e barabartë me 3,980,688 aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë/aksioni.
3. Shoqëritë “Bursa e Tiranës” Sh.a në likuidim, “Berateks” Sh.a në likuidim, “Kombinati Energjitik” sh.a. në likuidim dhe të shoqërisë “Nimeks” Sh.a në likuidim, pas përfundimit të bashkimit, vlerësohen të prishura dhe çregjistrohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
4. Ngarkohet shoqëria “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar dhe të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Delina IBRAHIMAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA  
RAJONI QËNDROR

Nr 484 Prot

Tiranë më 20 .01.2022

**Lënda: Lirim nga barra siguruese mbi titujt e pronësisë.**

**Për:**

**QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT**

**TIRANË**

Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Qëndror, ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit tatimor mbi pasuritë e tatimpaguesit me Nr. 3944 Prot. Datë 18.12.2020 :

**Tatimpaguesi :** "NIMEKS"  
**NIPT:** J62006501S  
**Perfaqesues :** Ardiola Huta me nr ID H46009041M  
**Adresa :** TIRANA, Durres, Durres

Te lirohen barrat mbi titujt e pronësisë të tatimpaguesit të sipërcituar pasi subjekti ka paguar të gjitha detyrimet sipas regjistrimeve tona.

**DREJTOR I DREJTORISË SË MBLEDHJES SË  
DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA  
RAJONI QËNDROR  
Edvin GRUÇKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E MBLËDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA  
RAJONI JUGOR

Nr. 91 prot.Fier, më 19.01.2022

Lënda: Kërkesë për Lirim e Vendosijes se Masës së Sigurimit të detyrimit tatimor.

Drejtuar: QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

1- Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Jugor, ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit tatimor mbi pasuritë e tatimpaguesit:

Administratori: Gramoz Hazizolli

Emri i tatimpaguesit: BERATEKS

NIPT/SSN: K826070010

Aktiviteti: Proçeset përfundimtare të përpunimit të tekstileve

Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve Berat , Berat, Berat.

2- Ne vazhdim te te gjithë njoftimeve per Masës së Sigurimit të detyrimit tatimor qe ju eshte derguar Juve me sherbim postar .

3- Tatimpaguesi ka kryer pagesen per detyrimet tatimore te papaguara sipas Masës së Sigurimit te derguar prane jush.

Per kete arsye nuk ka shkaqe ligjore per ruajtjen e metejshme te Masës së Sigurimit.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR IDREJTORISE SE MBLËDHJES SE DETYRIMEVE TATIMORE TE  
PAPAGUARA  
RAJONI JUGOR  
ANILDA ALIAJ

Di.19.01.2022

